


AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

PROMOVIMI I BOTIMIT

AKADEMIK ALEKS BUDA KUJTIME



5 QERSHOR 2015
ORA 12:00
SALLA E ASHAK

ALEKS BUDA - KUJTIME 2

Pas botimit të vëllimit I me kujtime të prof Aleks Budës, që u prit mjaft mirë në rrethet shkencore intelektuale, Tatjana Buda, pas një pune disavjeçare vjen para lexuesit me vëllimin II që mbulon periudhën nga viti 1945 deri në ditët e fundit të jetës së tij. Ky libër i shkruar me një njohje nga afër të jetës dhe personalitetit të Aleks Budës, plotëson profilin e tij si shkencëtar dhe si Njeri dhe paraqet një portret të vizatuar me ngjyra të gjalla, me dashuri dhe me një stil mbresëlënës, të këtij kolosi të shkencës dhe të kulturës shqiptare të shekullit që shkoi, emblemë e identitetit tonë shkencor, i njohur ndërkombëtarisht si albanologu dhe ballkanologu që e bëri shkencën historiografike shqiptare fakt dhe faktor të mendimit shkencor bashkëkohor europian.


Objektiviteti dhe besnikëria ndaj fakteve është tipari themelor që e shquan këtë libër kujtimesh për Aleks Budën, libër që, edhe pse i shkruar prej së bijës, i është shmangur subjektivizmit duke i lënë përshtypjen çdo lexuesi dhe bashkëpunëtori të profesorit se në faqet e librit takon Njeriun dhe shkencëtarin e vërtetë që ai ka njohur. Kjo është një vlerë e rrallë e këtyre kujtimeve që e dallon këtë libër nga veprat e tjera të kësaj natyre që shpesh vuajnë nga subjektivizmi dhe vështrimet e njëanshme. Për pasojë libri i shërben njohjes së veprimtarisë së shumanshme të prof. Aleks Budës si shkencëtar, si veprimtar i shquar i kulturës dhe i arsimit, si një nga protagonistët e jetës shkencore e kulturore të kohës për ndërtimin e kulturës së re dhe sidomos për zhvillimin e studimeve albanologjike shqiptare, falë të cilave qendra e tyre u zhvendos nga jashtë, brenda Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë spikat roli i prof. Budës për ngritjen e një institucioni të tillë si Akademia e Shkencave dhe e institucioneve të saj, jo vetëm si kryetar i parë i saj, por si ideator i projekteve madhore shkencore që ngritën lart prestigjin e albanologjisë si shkencë kombëtare, si historiani që u dha përgjigje disa prej çështjeve themelore të historisë kombëtare, çështjes së prejardhjes dhe formimit të popullit shqiptar, të gjuhës e të kulturës së tij, të autoktonisë së shqiptareve në trojet e tyre dhe të njësisë etnike të popullit tone, të rolit të shqiptarëve në historinë ballkanike, të formimit të formacioneve shtetërore në shekuj, e të tjera.

Aleks Buda, siç është thënë me të drejtë, ka qenë ambasador i shkencës dhe i kulturës shqiptare në botë. Vendi i gjerë që zë ky aspekt në libër është një nga vlerat dhe meritat e veçanta të kësaj vepre. Falë erudicionit, kulturës dhe njohjes së tij, në takimet ndërkombëtare dhe me ndërkombëtarët, Aleks Buda si askush i ka shërbyer njohjes së historisë dhe kulturës sonë në botë si dhe paraqitjes së një imazhi real të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Aleks Buda me veprën e tij ka nderuar e përfaqësuar Shqipërinë dhe shkencën shqiptare në aeropagun e shkencës botërore.

Botimi i këtij libri i shërben, veç të tjerave njohjes së historisë së krijimit e të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave, rolit të saj në jetën shkencore e kulturore të vendit.

Tatjana Haxhimihali



Akademik Aleks Buda